



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI KONTRAKTOR
SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME DIBËR SH.A
NJESIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot

Datë ____/____/2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje klori”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Klor - 24311900-6.

Vlera e Fondit Limit: 3,120,000 (tre milion e njëqindë e njëzetë mijë) Lekë pa TVSH

I mbajtur sot me date 09.02.20265 ne ambientet e Shoqërise Rajonale Ujësjellës Kanalizime Diber sh.a , nga njesia e prokurimit, ne zbatim te Urdherit te prokurimit nr.115/3 date 03.02.2026 ,per objektin e prokurimit; “Blerje Klori”, per nevojat e shoqërise.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor Shoqëria Rajonale U.K. Dibër, njesia e prokurimit , ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë;

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës**
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës**

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kriterëve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit, pika 1 e shtojcës 8 të DT .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet. *Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e*

përmbyshur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar nenin 44, pika 1, paragrafi b), si dhe neni 64 i ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 (i ndryshuar) “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të ligjit nr 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, V.K.M. nr. 922 datë 29.12.2014, "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, etj.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet e viteve , tre viteve të fundit 2022,2023,2024, të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbyshur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Shënim: Në respektim të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 43, pika 4, kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbyshur n.q.s. bilancet e njëpasnjëshme nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 ”Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe neni 41, pika ”c”, e ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 ”Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, në zbatim të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", etj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, OE duhet të dëshmojë për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbyshjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën minimalisht jo me te vogël 40% të vlerës limit të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik ofrues duhet të jete i pajisur dhe të paraqese certifikatat e leshuara nga organizmat e vleresimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, që janë në përputhje me objektin e kontratës, certifikatat kerkohen të jene të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. si me poshte:

- ISO 9001:2015 ose ekuivalente në fushën e menaxhimit të cilësisë
 - ISO 14001:2015 ose ekuivalente në fushën e menaxhimit të mjedisit,
- (Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat ISO sipas zërave që ka marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit)*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe me rekomandimin e A.P.P., datë 20.03.2018, prot 3341/1. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë, e rrjedhimisht është e drejtë e A.K. t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat të leshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

ISO 9001 : 2015 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizejnimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin.

Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij

ISO 14001:2015 ose ekuivalente në fushën e menaxhimit të mjedisit,

Kjo certifikate , specifikon kërkesat e përgjithshme për ngritjen e një sistemi të menaxhimit mjedisor në një kompani. Ajo fokusohet në njohjen e të gjitha aspekteve mjedisore dhe menaxhimin efektiv të pasojave të aktivitetit të një kompanie duke i mundur asaj të përmirësojë ndikimin e performancës së përgjithshme mjedisore të kompanisë.Kjo ka për qëllim sistemet e menaxhimit mjedisor të ofrojnë mundësinë për të identifikuar, vlerësuar dhe menaxhuar aspektet mjedisore të një shoqërie me qëllim:

Parandalimi i dëmtimit të mjedisit,Vlerësimi i aspekteve mjedisore,Rritja e performancës mjedisore,Respektimi i ligjeve,Ruajtja e burimeve natyrore dhe reduktimi i kostos,

Kjo certifikate që kerkohet nga autoriteti kontraktor ka një seri rregullash që siguron për mbrojtjen e mjedisit nga furnizuesi dhe nga përdorimi i mallrave të prodhuara prej tij kërkesa për kete certifika garanton autoritetin kontraktor se nuk do të ketë rrezik për mjedisin .

Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të mjedisit gjatë ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

2.3.3 Ofertuesi duhet të vërtetojë se produkti që do të furnizohet është i përshtatshëm në trajtimin e ujit të destinuar për konsum njerezor, konform normave europiane:

Për këtë qëllim duhet të paraqitet si dokument kualifikues **(Certifikate)** EN 901:2013. dokumentacion nga prodhuesi, ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi të akredituara nga institucionet perkatese, që dëshmon që produkti i prodhuar plotëson Standartin Europian të kerkuar EN 901:2013” ose

ekuivalente me te dokument qe ploteson standartin shqiptar S SH/EN 901:2013 mbi parametrat e Hipokloritit të Natriumit.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të nenit 40 të V.K.M. nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilën parashikohet shprehimisht.... Se Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; dhe/ose
c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Sa më sipër në vlerësimin e Autoriteti Kontraktor ky kriter ligjor është i domosdoshëm pasi objekti i prokurimit për vetë natyrën e tij ka një impakt social të rëndësishëm pasi bëhet fjalë për ujin e pijshëm ndaj edhe garancitë që Autoriteti Kontraktor synon të përftojë me anë të vendosjes së kriterëve duhet të jenë të një niveli të lartë për të konkluduar me përmbushjen e suksesshme të kontratës objekt prokurimi.

Në mbështetje të bazës ligjore të sipërpërmendur njësia e prokurimit gjykon se vendosja e kërkesës së mësipërme në kushtet e veçanta të kualifikimit Autoriteti Kontraktor ka për qëllim të vërtetojë se për produktet që prokurohen nuk do të përmbajnë lëndë të huaja dhe toksike të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në shëndetin e popullatës (konsumatorëve).

2.3.4 Ofertuesi duhet te paraqesi certifikaten e analizes nga Instituti i Shendetit Publik, ose dëshmi të lëshuara nga autoritete/institucione/ente të autorizuar për lëshimin e tyre, per analize toksikologjike per NaOCl. (hipoklorit natriumi) te marre brenda tre muajve te fundit nga data e zhvillimit te tenderit.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të nenit 40 të V.K.M. nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilën parashikohet shprehimisht.... Se Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

2.3.5. Ofertuesi duhet te paraqese autorizim prodhuesi ose distributori zyrtar per artikullin objekt prokurimi Hipokloriti të Natriumi NaOCl 13-15%. Ofertuesi duhet te paraqesi gjithashtu dhe certifikaten e analizave nga prodhuesi i Hipoklorit Natriumi NaOCl 13-15%.

1. Në rast se ofertuesi është vetë prodhues, duhet të paraqesë:

- Çertifikatën që vërteton konformitetin e produktit me standardin SSH EN 901: 2013 “*Kimikate që përdoren për trajtimin e ujërave të destinuara për konsum njerëzor*”
- Leje mjedisore e tipit A të lëshuar nga Ministria e Mjedisit për kimikatin e kërkuar.

2. Në rast se ofertuesi nuk është vetë prodhues, duhet të paraqesë:

- Autorizim të prodhuesit për ofertuesin ose autorizim për ofertuesin nga distributori i autorizuar prej prodhuesit ose që ka lidhur Marrëveshje Bashkëpunimi me prodhuesin (ose ekuivalenti i tij/saj) sipas ligjit, përpara noterit. Gjithë këto dokumente duhet të kenë afat vlefshmërie për gjithë kohëzgjatjen e kontratës të kësaj procedure prokurimi, i cili duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: *telefon, fax, e-mail, ëbsite*, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Ku në rast se autorizimi është lëshuar nga distributori duhet të paraqitet edhe Autorizimi/ Marrëveshja e bashkëpunimit midis distributorit dhe prodhuesit, e cila duhet të jetë e vlefshme në datën e zhvillimit të tenderit.
- **Çertifikatën e origjinës, cilësisë dhe Skedë teknike** të lëshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produktit të prodhuar me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara.
- **Lejen e importit** të lëshuar nga Komisioni i Liçensave pranë Ministrisë së Shendetësisë për llojin e kimikatis, në rast se ofertuesi është vetë importues, dhe në rast se nuk është vetë importues, duhet të paraqesë kontratën e furnizimit me një importues të këtij malli i cili disponon lejen e importit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi dhe duke vlerësuar rendesine dhe ndjeshmerine e objektit te kontrates pasi kemi te bejme me substance e Klorit e cila do te perdoret per trajtimin e ujit te pijshem , është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës plotësojnë kërkesat e legjislacionit specifik për realizimin e kontrates. Në këtë kontekst, referuar natyrës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e certifikates nga prodhuesi, lejes mjedisore, licensat dhe makinerine e kerkuar kërkon të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues.

(shënim - përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse të furnizimit, ose nëse është rasti të prodhimit të mallrave objekt prokurimi, që lidhet me objektin e kontratës së prokuruar).

- standardin SSH EN 901: 2013 ‘Kimikate që përdoren për trajtimin e ujërave të destinuara për konsum njerëzor, përcaktuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Standartizimit.
- Ligji nr. 10448, datë 14.07.2011, “Për lejet e mjedisit”,
- Ligji nr. 105/2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”.

Gjithashtu kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020, neni 73 datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar neni 40, pika 6, germa “c”, i jep mundësinë autoriteteve kontraktorë t’u kërkojnë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Njësia e Prokurimit gjykon se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi.

Pra nëpërmjet vendosjes së kriterit të sipërpërmendur Autoriteti Kontraktor garantohet dhe fiton siguri se Operatori Ekonomik kontraktues do të furnizojë dhe do të përmbushë kontratën me sukses. **Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

2.3.6 Ofertuesi duhet të paraqesë skedë sigurie për hipoklorit natriumi lëshuar nga prodhuesi (e perkthyer dhe noterizuar në shqip). Në rast paraqitje autorizimi distributori ofertuesi duhet të paraqesë autorizimin ose marrveshjen midis prodhuesit dhe distributorit të vlefshme. Autorizimi të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit (email tel etj) kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020, neni 73 datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar neni 40, pika 6, germa “c”, i jep mundësinë autoriteteve kontraktorë t’u kërkojnë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Njësia e Prokurimit gjykon se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e **Skedes se sigurise** është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion (skeden e sigurise)

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet paraqesë një deklaratë me shkrim që merr përsipër me mjetet e veta dhe me punonjësit e vet të realizojë shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi në kohë dhe në sasi sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor

Argumentimi kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020, neni 73 datë

23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar neni 40, pika 6, germa “c”, i jep mundësinë autoriteteve kontraktorë t’u kërkojnë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit,

Ak per te qene e garantuar qe furnizimi me klor do te behet sipas grafikut te caktuar I kerkon OE fitues qe te paraqes nje deklerate me shkrim ku merr persiper te furnizojte me mjetet e veta dhe punonjesit e tij furnizimin me klor per Ak.

Njësia e Prokurimit gjykon se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e **deklaratës me shkrim per furnizimin e Ak** është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara

2.3.8 Operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin:

Magazine për mbajtjen ne kushtet e duhura te mallrave objekt prokurimi ,kur ambjenti eshte ne pronesi duhet te jete I pajisur me :

-Certifikate pronesie

-Akt-miratim higjeno sanitar

-Si dhe foto të ambjenteve të ushtrimit të aktivitetit.

Ne rastin se ambjenti eshte me qera , duhet te paraqesi kontrate qeraje te noterizuar dhe te gjitha dokumentat e mesiperme.

Argumentimi kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020, neni 73 datë

23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar neni 40, pika 6, germa “c”, i jep mundësinë autoriteteve kontraktorë t’u kërkojnë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, ndaj per kete arsye Ak do te sigurohet qe realizimi I kontrates do te behet I sigurt dhe per kete qellim kerkon qe OE duhet te kete nje magazine ku deshmon qartazi se ka kushte dhe kapacitet mbajtes per ruajtjen dhe magazinimin e klorit qofte prodhues apo edhe tregtues. Deshmia e magazines tregon seriozitetin e OE lidhur me objektin e prokurimit.Njësia e Prokurimit gjykon se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e **Magazines** është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë vendosur në përputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 të ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, nenin 40, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Për objektin e prokurimit: “Blerje klori dhe reagente”.

Specifikimet teknike

Hipokloriti i Natriumit duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

-Përqindja e klorit aktiv 13- 15%

-Gjendja lëng i kthjellët

-Ngjyra e verdhë e çelët

-Densiteti 1.1 deri në 1.2 kg/litër

-PH < 8.0

-Koha e nevojshme e kontaktit > 30 minuta

-Turbullira < 0.5 NTU

Klori duhet të jetë i ambalazhuar në fuçi të mbyllura në mënyrë hermetike dhe i siguruar që të mos ketë rrjedhje. Çdo parti klori e ardhur në Ujësjiellës Dibër sh.a do të shoqërohet me fletë analizën e laboratorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Shëndetit Publik Tiranë. Përqindja e klorit aktiv në Hipokloritin e Natriumit nuk pranohet poshtë 13%

Sasia e klorit nuk do të sillet e gjitha njëherësh por sipas kërkesës (grafiku i levrimit) së bërë nga Ujësjiellës Dibër sh.a.

Çdo parti malli e ardhur në Ujësjiellës do të ketë Etiketimin si emertimin e mallit, emrin e fabrikës prodhuese apo importuesit, datën e prodhimit dhe afatin e skadencës. Çdo parti malli do të shoqërohet me certifikatën e garancisë për cilësinë, jetëgjatësinë dhe afatin e skadencës. Amballazhi është i parikthyeshëm.

Në çdo kohë Ujësjiellësi Dibër ka të drejtë testimin e Klorit aktiv në Hipokloritin e Natriumit. Reagenti DPD-1 HANNA është për të përcaktuar sasinë e klorit mbetës në ujë.

Argumentimi:

Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr.285 date 19.05.2025 , i ndryshuar dhe neni neni 44 kërkesat e cilësisë

Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Në zbatim të neneve 36, 37 të LPP-së në të gjitha rastet kur përmendet “markë” përfshihet termi “ekuivalent”.

Perlllogaritja e fondit limit:

Per përlllogaritjes së vlerës së fondit limit, eshte bere ne zbatim te nenit 34 e 35 te ligjit 162/2020 Per Prokurimin Publik , ky proces është argumentuar dhe dokumentuar sipas të gjitha parashikimeve ligjore/nënligjore duke përfshirë alternativat , ku jane marre ne konsiderate, Cmimet e tregut Dhe e gjith menyra e perlllogaritjes eshte pasqyruar ne procesverbalin e mbajtur per kete qellim I cili do te jete pjese e dosjes se procedures se prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT